



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr.29

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Prishtinë, më 9 mars 2022, në orën 11:30

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fatmire Kollçaku, Miljana Nikoliq, Labinotë Demi- Murtezi, Haxhi Avdyli, Burim Meta, Mirsad Shkreta, Bekim Haxhiu, Floretë Zejnullahu, Shemsedin Dreshaj, anëtarë.

**Munguan:** Armend Zemaj dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

**Pjesëmarrës i ftuar:** Dr. Rifat Latifi, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë.

**Stafi mbështetës:** Besim Haliti, zyrtar i lartë i fushës/analist.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Kujtim Salihu, Lumturije Bekaj –MSH dhe Violeta Salihu, KSHMS.

Mbledhjen e kryesoi Fatmire Kollçaku, kryetare e komisionit.

**RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, z. Rifat Latifi  
**Temat:** Puna dhe sfidat e Ministrisë së Shëndetësisë;  
Roli mbikëqyrës i Ministrisë në raport me SHSKUK–në;  
Strategjia Legjislative e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2022.

3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

**Fatmire Kollçaku** fillimisht ka kërkuar mirëkuptimin e anëtarëve të Komisionit, lidhur më vonesën e ministrit, pasi që është në mbledhje të Qeverisë “Çështja është që unë u sigurova që as ministri nuk e ka ditur për këtë mbledhje që është thirrur mbarmë vonë dhe mund të vonohet deri në orën 11:45”. Ju lus që të deklaroheni që a ta presim ministrin për raportim apo ta shtyjme mbledhjen?

**Labinothë Demi- Murtezi** tha që është mirë më pritur për një kohë, sepse e ka dhënë arsyetimin e vonesës për shkak të mbledhjes së Qeverisë, dhe është mirë që këto tema t’i diskutojmë sot, pasi në Kuvend po thuaj së vazhdimisht po kemi seanca plenare dhe aktivitetet të tjera të komisionit.

**Bekim Haxhiu** tha se mbledhja e Qeverisë nuk dështon për shkak të mungesës së ministrit Rifat Latifi. “Ka bukur kohë që kemi bërë kërkesë që të takohet me ministrin rreth agjendës legjislative. Kjo çka po ndodh sot, tregon fytyrën e vërtetë të kësaj qeverie, që nuk çan kokën për deputetë”.

**Burim Meta** tha se “Nuk është hera e parë që ministri vonohet në takimet tona. Duke pasur parasysh që në mbledhjet e qeverisë, ka kuorum, më së shumti që ministri është dashur të vonohet është ora 11:00. Ne jemi deputetë dhe kemi agjendat tona. Ministri do të duhej të vinte me bashkëpunëtorët e vet. Në të kundërtën mendoj se ky takim të shtyhet për një ditë tjetër”.

**Fatmire Kollçaku** sqaroi së tani sa më njoftoi stafi i komisionit, që ministri është duke ardhur në mbledhje të komisionit dhe 3 deri në 5 minuta mbërrin në Kuvend. Takimi po fillon më vonës për arsye që i cekëm, ajo për çka kemi për të diskutuar sot siç e dinë janë disa tema që i kemi adresuar sikur që janë Puna dhe sfida, Roli mbikëqyrës i Ministrisë në raport me SHSKUK –në dhe Strategjia Legjislative e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2022. Deri tani sa herë që kemi ftuar ministrin për tema të caktuar në është përgjigjur pozitivisht në ftesa, pasi e kemi prezent në mbledhje Ministrinë e Shëndetësisë Dr. Rifat Latifin, po ia jap fjalën për të na paraqitur ekspozenë, lidhur më temat e adresuar për ministrin nga Komisioni.

**Rifat Latifi, ministër i Shëndetësisë,** fillimisht kërkoi falje për vonesën tha që arsyeja ka qenë se mbrëmë na ka ardhur ftesa për mbledhje të qeverisë që ishte në orën 10.00, dhe jam detyruar që këtë takim me ju ta shtyjme dhe ju falënderoi për mirëkuptimin tuaj. Ai tha që për gjitha temat që keni adresuar si komision dhe për gjitha sferat e shëndetësisë do të punojmë së bashku. Ai pastaj i paraqiti prioritet dhe planin e punës së Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2022-2025 në 7 (shtatë) shtylla.

**Shtylla e parë është:** Strategjia Legjislative e MSH-së për vitin 2022, ku janë të parapara këto projektligje si në vijim: Projektligji për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar; Projektligji për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse; Projektligji për ndryshimin e ligjit nr. 04/L125 për shëndetësi; Projektligji për plotësim-ndryshimin për sigurimet shëndetësore; Projektligji për produkte dhe pajisje medicinale dhe Hartimi i projektligjit për rregullimin e çmimit të barnave; “Disa prej këtyre projektligjeve duhet të keni ndryshime dhe plotësime, po ashtu kemi edhe 16 udhëzime e rregullore që do ta ndihmojnë shumë shëndetësinë e Kosovës”.

**Shtylla e dytë është:** Kthimi i ekspertëve, por edhe ruajtja e ekspertëve që i kemi brenda. Masa ligjore të posaçme lehtësues për shkencëtarët dhe klinikistët e suksesshëm që jetojnë dhe punojnë jashtë Kosovës, por që dëshirojnë të kthehen dhe t’i bashkëngjiten rindërtimit dhe transformimit të shëndetësisë dhe shkencave mjekësore, si dhe dërgimin e mjekëve tanë në specializime jashtë vendit.

**Shtylla e tretë është:** Qendra Klinike të Ekselencës dhe Shërbime të avancuara klinike sikur se janë:

- 1.Qendra e traumës,
- 2.Qendra e kancerit,
- 3.Kirurgjia endovaskulare,

4. Neurokirurgjia
5. Kardiokirurgjia pediatrike
6. Shërbime tjera sikurse janë operacionet me kirurgji minimale laparoskopike; shërbimet e transplantimit të veshkave!
7. Zgjerimi i telemjekësisë në të gjithë vendin pas spitaleve rajonale;
8. Themelimi i Qendrës Simuluese dhe Edukimit Teknologjik për të gjithë punëtorët shëndetësor si pjesë e Qendrës Kombëtare të Telemjekësisë së Kosovës që ekziston që nga viti 2002.

**Shtylla e katër është:** Krijimi i Qendrës Klinike Hulamtuese Shkencore, në vendin tonë. Për të edukuar dhe ndihmuar shkencëtarët e ardhshëm klinik dhe të integruar të Kosovës përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërdisiplinar; Shpërndarja e hulumtuesve në të gjitha sektorët klinike; Zhvillimi i programeve shkencore dhe protokolleve hulumtuese.

**Shtylla e pestë është:** Proceset e Akreditimit Ndërkombëtar: Akreditimi ndërkombëtar i programeve të specializimeve, d.m.th. programeve post diplomike; Akreditimet ndërkombëtare të spitaleve publike dhe private; Akreditimi ndërkombëtar (në fillim, e më pastaj nga Kolegji i Kirurgëve të Kosovës dhe trupave tjerë) i qendrave të ekselencës sikurse ajo e traumës, qendrës së kancerit e të tjera.

**Shtylla e gjashtë është:** Përmirësimi i Cilësisë së Shërbimeve Mjekësorë; Auditimi i Cilësisë i të gjitha Shërbimeve Klinike dhe shpërndarja e auditorëve klinikë në çdo spital.

**Shtylla e shtatë është:** Decentralizimi i sistemit spitalor Riorganizimi i SHSKUK dhe QKUK-së.

**Shemsedin Dreshaj** tha së të gjithë e dimë së shëndetësia është një vorbull i problemeve që janë grumbullor tani që dy dekada, prandaj secili institucion këshillues duhet të dëgjohet për të dalë nga kjo situata e krijuar për një kohë të gjatë, ajo që i takon një menaxheri të ri është të fillohet aty ku janë problemet, por e vërteta deri më sot është së nuk kemi parë as nga kjo Qeveri, së e ka prioritet shëndetësinë. Lidhur më ndarjen e specializimeve ka bërë apel që specializimet të mos ndahen sikurse që ka ndodhur deri më tani, prandaj specializimet duhet të ndahen nga Ministra e Shëndetësisë, sipas nevojave që kanë klinikat në kuadër SHSKUK-së; QKUK-së, të spitaleve rajonale dhe të QMF-ve, dhe mos të presimi, siç na ka ndodhur deri tash që specializimet të ndahen çdo 4-5 vjet kur të grumbullohet numri i tyre, pastaj po ka problem në sistemin e tyre, hapja e specializimeve duhet të lejohet që bëhet më shpesh, vetëm sipas nevojave që i kërkojnë institucionet përkatëse. Ajo që nuk është e mirë për sistemin tonë shëndetësor, tha së është heqja e vijës buxhetore për hulumtimet shkencore dhe me buxhet të reduktuar të gjitha këto probleme nuk do të kenë mundësi të përmirësohen. Ai ka thënë se lista e pritjeve për operime në disa klinika të SHSKUK-së është e dhimbshme, po ashtu e dhimbshme është edhe lista e pritjes për procedurat diagnostifikuese. Ndërsa sa i përket riorganizimi të SHSKUK-së dhe QKUK-së, tha që kjo duhet të bëhet më anë të plotësim ndryshimit të Ligjit për Shëndetësi.

**Rifat Latifi, ministër i Shëndetësisë** potencoi sa i përket specializanteve, së duhet që t'ju mundësohet që t'i përgatisim jashtë vendit duke i dërguar në Zvicër, Gjermani, Slloveni, Kroaci dhe në vendet tjera, "Synojnë procesin e akreditimeve të programeve siç është ai i programeve të specializimeve, programeve publike dhe private, akreditimi i qendrave të ekselencës, kancerit të gjirit, onkologjisë e disa të tjera".

**Fatmire Kollçaku**, sa i përket çështjes së specializimeve, tha se nuk janë të rregulluar mirë me anë të udhëzimit administrativ, që është për specializimet dhe mentorët që e përcjellin punën e tyre në shumicën e rasteve e kanë penguar avancimin e specializanteve.

**Bekim Haxhiu** tha se pos listës së madhe të pritjes për operime që janë në disa klinika kirurgjike që duhet të pritet për një kohë të gjatë për t’ u bërë operimi i pacienteve fatkeqësisht, kemi edhe lista e pritjes për procedurat diagnostikuese, si kjo listë e pritjes është rritur dhe për fajin e menaxhmentit dhe Bordit SHSKUK-së dhe të disa drejtoreshave të klinikave. Ai ka parashtruar disa pyetje: A ka llogaridhënie nga bordi drejtuesi i SHSKUK-së, pasi që këta në bazë të Ligjit për Shëndetësi ju raportojnë juve si ministrit i shëndetësisë? A do të vazhdoni me këtë bord të dështuar që kanë dështuar në menaxhimin punëve të shumta brenda SHSKUK-së? “Ky bord përveç që i ka venë në lajthitje qytetarët i ka venë në lajthitje edhe krerët e shtetit kur e kanë prerë shiritin për spitalin pediatrik të fëmijëve, që nga viti i kaluar kur është bërë edhe ceremonia e pranimit-dorëzimit, por që në fakt ky spitali për fëmijët nuk është end funksional, është koha për veprim që ta shkarkoni këtë bord të papërgjegjshëm të SHSKUK-së”. A do të vazhdoni me modelin aktual të SISH-it (Sistemi Informativ Shëndetësor) siç është apo do ta merreni një model tjetër? Sa do të jetë paga e një profesionisti shëndetësor? Sa prej vaksinave kundër COVID -19 Astra Zeneca të pranuar nga Gjermania dhe Kroacia janë administruar dhe sa kanë skaduar? Të Programi Legjislativ, për vitin 2022, pse nuk keni papara Projektligjin për Transplatimin e Organeve? A do ta hartoni projektligjin për specializimi për ta rregulluar këtë dikaster më ligj? Për kontratën që ka nënshkruar MSH më organizatën UNPOS për furnizim, ku është bërë shmangia nga Ligji i prokurimit, por më këtë kontratë në disa rast kemi furnizim më barna shumë të shtrenjtë së sa që janë më çmimi të tregut, tani çka ka përfituar MSH-e nga kjo kontrate për furnizim? Cili është projekti që e ka planifikuar MSH-e për investime në klinikën e emergjencës?

**Rifat Latifi, ministër i Shëndetësisë**, ju është përgjigjur pyetjeve: tha se të gjitha këto pyetje janë të rëndësishme, për investime në klinikën e emergjencës, tha që duhet të vendoset në një vend, më Njësinë për Kujdesin Intensiv për pacientet, në mënyre që mos të ketë lëvizje të pacienteve nga një ndertës në ndërtesën tjetër. Për modelin e SISH-it tha që do të merret diçka nga ky aktual, pasi që ka funksionuar mirë në programin e vaksinimit dhe do ta marrim këtë model të programit. Për programin legjislativ, tha që këto janë parapara për këtë vit duke përfshirë dhe Ligjin kryesorë atë për Shëndetësi. Lidhur më kontratën që ka nënshkruar MSH-e për furnizim më UNPOS, tha që mundeni më e shikuar këtë kontratë, furnizimet bëhen sipas rregullativave që i ka kjo organizatë, dhe ka pasur kursime buxhetore nga kjo kontratë që është lidhur më UNPOS-n. Sa i përket vaksinave kundër COVID -19 “AstraZeneca” të pranuar nga Gjermania dhe Kroacia, tha që nuk pasur donacione të këtyre vaksinave nga këto shtete. Ndërsa lidhur më listat e pritjes për operacione kirurgjike, tha që është një problem shumë i madhe më këto lista, sidomos në klinikën ortopedike, ku kemi mungesën e sallave dhe materialeve, saç janë protezat për operacionet e ligamenteve.

**Fatmire Kollçaku**, lidhur më lista e pritjes për operacione, tha që operimet duhet të behën, sipas prioriteteve që kanë nevojë me urgjente, sepse numri i pacienteve që presin për operime kirurgjike është shumë i madhe, andaj duhet shkohet dhe sipas rasteve sociale, pasi që këta pacientë, nuk kanë mundësi buxhetore për të u operuar në spitalet private.

**Burim Meta** tha se në Ministrinë e Shëndetësisë, është duke u punuar, por që nuk po pasqyrohet sa duhet puna e tyre opinionin publik, por janë disa punë dhe problem që duhet t’ ju jepet epilog dhe të mbyllen si procese. Në Spitalin pediatrik, tha që ka kohë që është bërë ceremonia e hapjes, por që në realitet nuk është realizuar funksionimi i tij. Lidhur më hulumtimet shkencore, a është bërë ndonjë kërkesë që të rritet buxheti për çështje? Kemi udhëzimin administrativ për specializantet dhe MSH-e, kur e ka hapë konkursin për specializime, e ka obligim që të bëjë pagesat e kujdestarive për

specializantet, po ashtu dhe më kontratën kolektive është detyruar të bëjnë pagesat mujore, por që nga nëntori i vitit të kaluar nuk janë paguar pagat e tyre, pse nuk po paguhen nga ana MSH-së? Po ashtu specializantet në vazhdimësi penalizohen dhe në kohën mbajtës së kujdestarive, andaj kujdestarit për specializantet duhet të paguhen nga MSH- sepse kontrata për specializime janë të nënshkruar më MSH-n, jo më SHSKUK-n. Sa përket agjendës legislative të MSH-së potencoi së koha kur do të fillojnë të vijën projektligjet është e vonë, sidomos Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shëndetësi, që është papara për muajin tetor është e vonë, duke e pasur parasysh kohën, që mund të na marrë për amendamentim ky ligj. Lidhur kontratën që e ka nënshkruar Ministria e Shëndetësisë që të furnizohen me insulina përmes UNOPS, kjo kontrate është dashur të bëhet për të ju shmangur procedurave të prokurimit, pasi që kanë qenë urgjencë furnizimi më to, dhe në mungese të bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, por tani një kontratë e tillë për furnizime të tjera më çmime të rritur më shumë se sa që janë më çmimin e tregut, nuk është nevojshme dhe e arsyeshme, kur ka punëtor të mjaftueshme në Zyrën e Prokurimit të MSH-së, dhe kanë obligim t'i kryejnë procedurat e prokurimit për të furnizuar më barnat esenciale që i duhen shëndetësisë së vendit.

**Rifat Latifi, ministër i Shëndetësisë,** lidhur më Spitalin e Pediatrikë tha, që e ka marrë vetë përsipër me udhëheq atë proces dhe po shkon shumë mirë. “Jam optimist që deri në fund të muajit mars ka me u bërë”, Për kontratën për furnizim më UNOPS, tha që e ka gjetur të nënshkruar dhe derisa të përfundon afati, kemi obligim të respektojmë zbatimin e saj, dhe furnizimin më insulina, ka bëra për dy muaj dhe në bazë të shpenzimeve që kanë do furnizohen QMF-et. Sa përket pagesave të kujdestarive, për specializantet, tha që tani jemi pajtuar më menaxhmentin e SHSKUK-së, që këto pagesa tash e tutje të bëjë ministria, pas që siç e theksuat ju deputetë, kontratat specializantet i kanë më MSH. “ Këto 7 shtyllat që i prezantova siç janë: Programi legjislativ, masat ligjore, duhet të jemi kreativ me format që t’ua lehtësojmë kthimin dhe jashtëzakonshme është shpërndarja e hulumtuesve dhe shkencëtarëve”.

**Haxhi Avdyli** pyeti për Sistemin Informativ Shëndetësor se a janë bërë përgatitjet për të filluar më këtë program? Sa i përket Ligjit për sigurimet shëndetësor, a keni bërë përgatitjet duhura dhe kur keni planifikuar për të filluar më veprime konkrete? Një numër i madhe i infermiereve dhe mjekëve janë angazhuar nga Ministria e Shëndetësisë më kontrata afat shkurtra ndaj luftimit të pandemisë me COVID-19, tani që jemi ka fundi i kësaj pandemie çka do të bëhet më këta punëtorë shëndetësorë? Si është gjendja e furnizimit më insulina nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare? Lidhur më sëmundjet e rralla a është ndarë buxheti vjetor nga ana e MSH-së për barna dhe materiale shpenzuese rreth këtyre sëmundjeve?

**Rifat Latifi, ministër i Shëndetësisë,** ju është përgjigjur pyetjeve: Për sëmundjet e rralla, tha që MSH-e ka filluar për herë të parë furnizimin më këto barna, por ka vend për përmirësime. Për angazhimin e punëtorëve shtesë shëndetësorë, tha që do të bisedojmë më komitetin për menaxhimin e pandemisë COVID-19, së deri kur janë të nevojshëm të jenë të angazhuar këta punëtorë shëndetësor, pastaj do t’ i shikojmë mundësit buxhetore për të juaj vazhduar kontrata. Për planifikimit e sigurimeve shëndetësor, tha së pari do të rregullohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Sigurime Shëndetësore, e pastaj të fillohet më zbatimin e ligjit duke e bërë mbledhjen e sigurimeve shëndetësore. Ndërsa sa i përket SISH-it, ka thënë se është duke u punuar në këtë drejtim, kemi ndarë buxhet për të bërë një studim dhe ka diçka të mirë në SISH, siç është programi i vaksinimit, që po funksionojnë mirë.

**Mirsad Shkreta:** Sa i përket vizitës të Komisionit që e kishte më Bordin drejtues dhe drejtorin e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, në diskutimet tona ne ju kemi referuar Raportit të Auditorit, ku Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, konstaton së menaxhimi i punëve në

SHSKUK, është dobët ka shkelje ligjore në shumë dikastere duke filluar nga dhënia e tenderëve, nënshkrimi i kontratës për ndërtimin e klinikes të hematologjisë, ndërtimi i secilës ka filluar pa pajisjen e lejes së ndërtimit nga Komuna e Prishtinës dhe Bordi i SHSKUK-së e ka dhënë pëlqimin duke nënshkruar kontratë pa i zbatuar procedurat që parashihen më ligj, nëse komuna nuk e jep lejnë e ndërtimit për këtë objekt, atëherë kompania ndërtuese që fituar tenderin, në bazë të kontratës, kur i ndërpritet puna, ka të drejtë t'i merr 70% të vlerës së shumës së përgjithshme të mjeteve financiare që është nënshkruar kontrata, andaj kjo është njëra prej keqpërdorimeve të shumta që kanë ndodhur dhe po ndodhin në institucionin e SHSKUK-së. Ai ka potencuar së në takimin që ishte më drejtuesit e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, kemi kërkuar listën e shërbimeve që kryhen në spitale, por ky institucion nuk e ka pasur të gatshme, na thënë së nuk kanë as plan të punës për resurset njerëzore, për lista e pritjes për operime, kirurgjike, nuk kemi marrë përgjigje të saktë, dhe nuk kanë dhënë përgjigjeje as për raportin financiar, ajo çka është më shqetësuese dhe kanë vepruar në kundërshtim më ligjin është kur drejtuesja e Bordit të SHSKUK-së, e kryeson komisioni për zgjedhjen e drejtoreshave Klinik. Ai ka kërkuar nga ministri i Shëndetësisë, Dr. Rifat Latifi, që t'i rekomandon Qeverisë së Kosovës, zëvendësim e bordit drejtues të SHSKUK-së, kur shkeljet janë evidentë, aq më tepër kur konstatohet së ky bord ka bërë shkelje ligjore në disa raste dhe kur këto shkelje janë gjetje në Raportin e Auditimit, atëherë, për ligjshmërinë e veprimeve të SHSKUK-së është përgjegjëse Ministria edhe në bazë të Ligjit për Shëndetësi, që është rregulluar si në vijim: **Neni 66 Mbikëqyrja e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës** 1. Mbikëqyrjen e veprimtarisë së SHSKUK e bëjnë Ministria dhe Qeveria e Kosovës. 2. Për të siguruar mbikëqyrjen e SHSKUK, Ministria dhe Qeveria: 2.1. mbikëqyrin veprimtarin dhe ligjshmërinë e punëve të SHSKUK; 2.2. kërkojnë dhe shqyrtojnë Raportet e rregullta vjetore dhe 3 (tre) mujore me deklaratën financiare, raportet e auditimit, dhe Raportet plotësuese mbi aktivitetin e SHSKUK nga Bordi drejtues; 2.3. ndërmarrin masa të tjera, të përcaktuara me ligj. Pyetje edhe për mirëmbajtjen e shtrenjtë të laurave që kjo kontratë i kushton QKUK-së 160 mijë euro për tri laura? Ai ka thënë se nuk do të ndalet deri në fund me të gjithë mekanizmat ligjor dhe kushtetues për ti zbardhur këto shkelje ligjore që kanë ndodhur nga bordi drejtues dhe menaxhmenti i SHSKUK-së.

**Rifat Latifi, ministër i Shëndetësisë**, sa përket Bordit drejtues të SHSKUK-së, tha që e ka vizituar dhe aty ka nevojë për një administrim të përgjithshëm, jemi duke e analizuar çështjen e bordit duke u marrë me statutin e krijuar do të merremi seriozisht ma ta dhe do të veprojme në bazë të ligjshmërisë.

**Floretë Zejnullahu** pyeti për çështjen e listave të pritjes të pacienteve që janë në Klinikën e Ortopedisë, Kardiologjisë, Radiologjisë dhe nëpër klinikat e tjera janë në numër të madh çka do të bënë konkretisht a keni ndonjë plane të veprimit lidhur më këtë situatë të krijuar si do t'ju qaseni këtij problemi të madh? Raporti i Auditorit për vitin 2021, për SHSKUK-së i cili është i kualifikuar më term ekonomik si raport të dobët dhe raport ka gjetje të shumta në keq menaxhim të punëve që ka bërë Bordi drejtues i SHSKUK-së, çka do të ndërmerreni për këtë bord ku raport i auditorit e ka nxjerrë të keq? Përveç listës së pritjes dhe dështimeve tjera të këtij bordi, më e keqja është kur kryesuesja e Bordit të SHSKUK-së njëjtën kohë është edhe kryesuese e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve të klinikave. Sa i përket barinave ka lëvizje të shumta të çmimeve edhe në programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2022 nuk është paraparë Projektligji për rregullimin e çmimit të barnave, andaj Ministria dhe Qeveria kanë dështuar sjelljen në Kuvend të këtij projektligji, ani se ky ligj është me nevojë urgjente sepse qytetarët po përballen me ngritje çmimesh të cilat variojnë nga një barnatore në tjetrën.

**Rifat Latifi, ministër i Shëndetësisë**, ju është përgjigjur pyetjeve: Lidhur më Projektligjin për rregullimin e çmimit të barnave, tha që tani MSH e ka futur në planin legjislativ e për vitin 2022

hartimin e këtij projektligji, dhe besoj që shumë shpejt do ta përfundojmë për ta proceduar për kuvend. Për lista e pritjes, tha që nuk janë rritur vetëm në Kosovë, por kjo rritje ka ndodhur në tërë botën, për shkak të pandemisë me COVID-19.

**Labinothë Demi- Murtezi** tha është për t' u inkurajuar krijimi i një grupi punës kaq të madhe me profesionist dhe ekspert të fushave brendshme dhe të jashtëm lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësin e ligjit për shëndetësi, po ashtu kishte qenë mirë që edhe komisioni të njoftohet për këta ekspertë që janë pjesë e grupit punues. Ajo theksoi së ne po jemi bashkë për t' i konstatuar sfidat dhe problemet që janë në shëndetësinë e Kosovës, por fatkeqësisht fajtori i problemeve po mbetet jetimi dhe pa adresuar, kemi një numër të vogël të inspektoreve shëndetëso, është shqetësuese kur këta inspektorë punojnë edhe sektorin privat të shëndetësisë, për largimin e mjekëve që po ndodh duhet të veprohet shumë shpejt, në mënyrë që të parandalohet largimi i tyre, dhe mos të ketë vetëm punësim ad-hok, por të punësohen me kontrata të përhershme, po ashtu edhe specialistet po trajtohen keq nga drejtoret e klinikave, ka rast kur nuk po ju lejohet për të hyrë në sallat e operacioneve kirurgjike dhe nuk po ju lejohet hapësirë për të mësuar, andaj për t' i rregulluar këtë sfida dhe problem Ministra e Shëndetësisë, duhet ta rrisin rrolin mbikëqyrës për veprimtarin dhe ligjshmërinë e punëve ndaj SHSKUK-së që kanë për obligim në bazë të Ligjit për Shëndetësi. Ajo tha që ka mungesë të pajisjeve me Rezonanca Magnetike nëpër spitalet rajonale, në këtë drejtim duhet të punojmë së bashku për të ndarë buxhet për blerjen e këtyre aparaturave, pasi që nuk janë shumë të kushtueshme në mënyrë që mos më pritur më muaj pacientet për një fotografim me rezonancë magnetike për në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, nëse blihen këto rezonanca magnetike për spitalet rajonale, atëherë qytetaret e këtyre komunave, këto shërbime kishin mundur të kryejnë në vendet e afërta të tyre nga janë dhe nuk kishin pasur nevojë më ardhur në Prishtinë për të shpenzuar para dhe kohë.

**Rifat Latifi, ministër i Shëndetësisë**, ju është përgjigjur pyetjeve: për çështjen inspektoreve shëndetësorë, pajtohem që duhet të rritet numri i tyre dhe t' ju krijohen kushtet për punë që të punojnë vetëm në sektorin publik. Lidhur me Projektligjin për Shëndetësi, e kam krijuar një grup të madh në mënyrë që rregullojnë shume problem që janë nëpër sektorët e shëndetësisë dhe të mos të ndërrohet ky ligj sa herë ndërrohet ministri. Sa përket spitaleve tha këto së e ka paraparë fuqizimin e tyre me ristrukturimin e sistemit shëndetësori në shtyllën e shtatë që është decentralizimi i sistemit spitalor dhe riorganizimi i SHSKUK-së dhe QKUK-së. A tha që do t'i listoj dy tema që nga këto sfida dhe problem që ka shëndetësia e vendit që dalim deri në fund këtyre probleme.

**Fatmire Kollçaku**, e falënderoi ministrin Shëndetësisë, Dr. Rifati Latifin, për temat e diskutuara, besoj që për këto tema kemi marrë përgjigje dhe sqarime. Ajo tha së këto tema që i diskutuam në këtë mbledhje, që një kohë komisionit i ngritur këto tema siç është Strategjia Legjislative e MSH-së për vitin 2022, Që të qartësohet se cilat projektligje ka në agjendë ministra për t'i sjellë në komision, pastaj paraqita punës dhe sfidat që ka MSH, dhe Roli mbikëqyrës i ministrisë në raport me SHSKUK-në, por kemi edhe shumë tema të tjera që do t' i trajtojmë në ardhmen në bazë të çështjeve dhe dikastereve që janë në kudër të ministrisë së shëndetësisë. Në fund kërkoi që të trajtohet më mirë stafi infermiereve edhe në aspektin e pagesave për kujdestari, të bëhet shpërndarja e barnave për terapinë e kancerit nëpër spitalet rajonale, dhe kjo çështje mund realizohet në mënyrë që pacientet të mos udhëtojnë për të ardhur klinikën onkologjisë në Prishtinë dhe të kursehen nga udhëtimi që vështirë për ketë kategori të pacienteve. Për rezonancat magnetike të ndahen mjete financiarë, ashtu siç janë ndarë për spitalin e Pejës, të ndahen edhe për spitalet e tjera rajonale.

### **3.Të ndryshme**

Për pikën të ndryshme nuk pati ndonjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

**Fatmire Kollçaku,**

**Kryetare e Komisionit**